



**VENDIM**

***Nr. 145, Datë 26.11.2015***

**PËR  
FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR RINOVIMIN E LIÇENSËS SË  
SHOQËRISË GSA SH.P.K NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT  
TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 57, DATË 22.06.2011**

Në mbështetje të neneve 16; 20 gërma “b”, 37 gërma “d” dhe 110 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4 pika 1 gërma “g”; 10 pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1 gërma “a”, të “Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve, Nr. 21, datë 18.03.2009, Bordi i E.R.E, në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k për rinovimin e liçensës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike,

**Konstatohet se:**

Aplikimi i shoqërisë “GSA” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të dhënat specifike sipas tipit të liçensës (neni 9, pika 4./10 gërmat “a”, “b” “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi :**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “GSA” sh.p.k për rinovimin e liçensës në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr .57, datë 22.06.2011.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Petrit AHMETI**